



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Tiranë, më 27/ 12 / 2022

KKDM/Nr. ....150..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

**VENDIM**

Nr.31, date 27 /12/2022

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGES SE BOVILLES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.12.2022 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, mirembajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digës së Bovillës të paraqitur nga Shoqëria e Ujesjelles-Kanalimeve të bashkise Tirane (UKT).

Dokumentacioni i kesaj rregulloreje të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre rregulloreve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. KTPD i rekomandoi antarëve të KKDM të miratoj rregulloren për shfrytëzimin e digës së Bovilles duke patur parasysh perditesimin e rregullores për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shkarkimit. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishem, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të miratoj Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digës së Bovillës të paraqitur nga Shoqëria Ujesjelles Kanalimeve të bashkise se Tiranes (UKT).
- 2- Ti kerkoj UKT :
  - Perditesimin e rregullores se shfrytëzimit, mirembajtjes dhe testimit te sistemit te shkarkimit ne digen e Bovilles;
  - Pergatitjen dhe dorezimin per miratim prane KKDM te planit te Gadishmerise ne rastet e emergjencave civile per shkak te perdorimit te diges se Bovilles. Ky plan duhet te pregatitet sipas udhezimeve te dhena ne Vendimin e KKDM Nr. 3, dt. 09.10.2020;
  - Marrjen e masave per instalimin e sistemit te alarmit ne digen e Bovilles si dhe monitorimin e rreshqitjes se konstatuar ne afersi te diges se Bovilles.
  - Informimin e KKDM ne lidhje me zbatimin e kerkeseve te mesiperme brenda muajit Qershor 2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**  
Arjan JOVANI

